



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

---



**RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT  
SHTETËROR TË CILËSISË DHE I AGJENCISË SË  
KOSOVËS PËR AKREDITIM PËR VITIN 2023**

Prishtinë, 2024

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b> .....	5
<b>2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)</b> .....	5
2.1 Misioni dhe qëllimet e AKA-së.....	7
2.2 Anëtarësimet dhe partneritetet.....	8
<b>3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KShC)</b> .....	8
3.1. Mbledhjet dhe vendimet e KShC.....	11
<b>4. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN 2023</b> .....	13
<b>5. KOMISIONI I ANKESAVE (KA)</b> .....	17
5.1 Baza ligjore:.....	17
5.2 Pjesëmarrje në hartim të legjislacionit dhe konferenca/punëtori:.....	17
5.3 Struktura dhe takimet e KA-së.....	18
5.4 Vendimmarrja e KA-së.....	18
<b>6. AKTIVITETET DHE NGJARJET KRYESORE TË AGJENCISË SË AKREDITIMIT NË VITIN 2023</b> .....	20
6.1. Shqyrtimi i aplikacioneve të akreditimit dhe aprovimi i planit të aktiviteve.....	20
6.2. Miratimi i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.....	20
6.3. Konferenca e parë ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.....	20
6.4. Rishikimin e standardeve për nivelin institucional dhe të programeve.....	21
6.5. Progres vizita e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).....	22
6.6. Agjencia e Akreditimit ka zbatuar procesin e monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë.....	23
6.7. KShC themeloi Grupin punues për hartimin e rregulloreve që dalin nga Ligji i AKA-së.....	25
6.8. Sesion informues lidhur me standardet dhe procesin e akreditimit të programeve.....	25
6.9. Aktivitete për zhvillimin e rregulloreve që dalin nga Ligji i ri.....	26
6.10 Sesion informues me IAL-të për procesin e aplikimit dhe deklarimit të stafit.....	26
6.11 Përmbyllja e procesit të deklarimit për 2700 staf akademik në Kosovë.....	26
<b>7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E PARTNERË</b> .....	27
7.1. Përkrahje nga ENQA dhe EQAR për zbatimin e standardeve evropiane.....	27
7.2 Komisioni Evropian: AKA ka zbatuar rekomandimet për pavarësi institucionale dhe operacionale.....	28
7.3 Agjencia e Akreditimit përfiton nga projekti i Shteteve të Bashkuara – USKEB.....	28

<b>7.4 Kosova po përfiton nga përvoja austriake në fushën e akreditimit .....</b>	<b>29</b>
<b>7.5 AKA pjesë e shkëmbimit të stafit me Agjencinë Gjermane të Akreditimit ASIIN</b>	<b>30</b>
<b>7.6 Nënshkruhet memorandum i mirëkuptimit në mes të AKA-së dhe projektit HEI'25.....</b>	<b>30</b>
<b>7.7 Agjencia e Kosovës për Akreditim nënshkruan kontratë për digjitalizim të proceseve .....</b>	<b>31</b>
<b>7.8 Kosova dhe Sllovakia po bashkëpunojnë për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë .....</b>	<b>31</b>
<b>7.9 Agjencia e Akreditim dhe Qendra NARIC shkëmbim përvojash me Republikën Çeke .....</b>	<b>32</b>

## **SHKURTESAT**

ADA – Agjencia Austriake për Zhvillim

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

CEENQA - Rrjeti i Evropës Qendrore dhe Lindore për Sigurimin e Cilësisë

ENQA - Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë

EQAR - Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë

ESG - Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë

HERAS - Higher Education, Research and Applied Science Plus

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë

IAL publik - Institucionet e Arsimit të Lartë të financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

IAL privat - Institucionet e Arsimit të Lartë të vet-financuara

INQAAHE - Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

KA - Komisioni i Ankesave i cili shqyrton ankesat e pranuar nga IAL për vendimet e KShC-së

KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

KShC - Këshilli Shtetëror i Cilësisë

Ligji për AL - Ligji për Arsimin e Lartë

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës , Teknologjisë dhe Inovacionit

QAINTE – Projekti Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë

RVV – Raporti i Vetëvlerësimit

SC - Sigurimi i Cilësisë

UA - Udhëzim Administrativ

WUS Kosova - World University Service Kosova

KSAC – Kodi i fushave të Studimit për Kosovë (Kosovo Subject Area Code)

## **1. HYRJE**

Ky dokument është përpiluar më qëllim të raportimit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2023.

Brenda këtij Raporti janë të vendosura informatat mbi aktivitetet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Komisionit të Ankesave për periudhën njëvjeçare.

Raporti pasqyron:

1. Proceset e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programet tyre të studimit të nivelit të V-të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Bachelor, Master dhe Doktoratës, për vitin 2023;
2. Aktivitetet dhe zhvillimet që kontribuojnë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së punës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si institucion vendimmarrës i AKA-së;
3. Adresimin e rekomandimeve për kthimin e anëtarësisë së plotë në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR); dhe
4. Bashkëpunimin me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

## **2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) u themelua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2008, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Ndërsa tani, Agjencia e Kosovës për Akreditim funksionon me Ligjin Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe ka status të agjencisë rregullatore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

AKA bën akreditimin, ri-akreditimin, validimin dhe monitorimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë dhe programeve të tyre të studimit. Përmes procesit të akreditimit, AKA mbështet zhvillimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë mënyrë siguron se ofertat për arsim të lartë në Kosovë përkojnë me standardet e krahasueshme ndërkombëtare.

Baza ligjore për aktivitetin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë<sup>1</sup> (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011), Ligji Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim<sup>2</sup> dhe Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018)<sup>3</sup>, Manualin për akreditim, rregulloret, etj. Që nga themelimi i saj, AKA në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG)<sup>4</sup> ka zhvilluar të gjitha standardet dhe procedurat për akreditim dhe i ka publikuar ato përmes ueb faqes së saj zyrtare.<sup>5</sup>

Akreditimi përfshin këto aspekte kryesore:

- Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë;
- Akreditimi i programeve të studimit;
- Akreditimi i institucioneve dhe programeve të studimit;
- Akreditimi i degëve dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në ato degë;
- Njohjen/validimin e akreditimit ndërkombëtar.

Sipas Nenit 7 të UA 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kërkesa për akreditim mund të bëhet nga:

- Vet institucioni i arsimit të lartë për tu vlerësuar në nivel institucional apo të programeve të studimit;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA, në raste të veçanta.

Me qëllim të zhvillimit të një procesi transparent të akreditimit, AKA ka përgatitur dokumentet e nevojshme mbi procedurat e akreditimit të cilat mund të shfrytëzohen nga IAL-të, si në vijim: Standardet e AKA-së, Udhëzuesit e AKA-së për Hartimin e Raportit të Vet-vlerësimit (RVV) për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, përkatësisht

---

<sup>1</sup> [Ligji nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në republikën e kosovës \(rks-gov.net\)](http://rks.gov.net)

<sup>2</sup> [Ligji nr. 08/L-110 për agjencinë e kosovës për akreditim \(rks-gov.net\)](http://rks.gov.net)

<sup>3</sup> [Udhëzim administrativ \(masht\) nr. 015/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në republikën e kosovës \(rks-gov.net\)](http://rks.gov.net)

<sup>4</sup> [https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/esg\\_2015.pdf](https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/esg_2015.pdf)

<sup>5</sup> <https://akreditimi.rks-gov.net/guidelines/>

Manualin e Akreditimit<sup>6</sup>. Këto dokumente kanë shërbyer jo vetëm si udhëzues për institucionet e arsimit të lartë për qëllim të procesit të akreditimit, por edhe si udhëzues për sigurimin dhe menaxhimin e brendshëm të cilësisë.

AKA përbëhet nga struktura administrative e saj, e cila udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i cili është organ qeverisës dhe vendimmarrës i AKA-së, si dhe nga Komisioni i Ankesave. Struktura administrative e AKA momentalisht ka të punësuar drejtorin, 12 zyrtarë si dhe 2 praktikantë.

## **2.1 Misioni dhe qëllimet e AKA-së**

Misioni AKA është të mbështesë zhvillimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë përmes procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të sigurojë shoqërinë e Kosovës se cilësia e arsimit të lartë është në nivelin e standardeve ndërkombëtare.

Qëllimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë si në vijim:

- të promovojë, përmirësoj dhe rrisë cilësinë e arsimit të lartë;
- të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në sistemin e arsimit të lartë;
- të përmirësojë cilësinë e studimeve në institucionet e arsimit të lartë;
- të inkurajoj përmbajtje inovative në arsimin e lartë;
- të sigurojë krahasueshmërinë e kualifikimeve nga institucionet e arsimit të lartë të Kosovës me ato të dhëna nga programet ndërkombëtare;
- të zbatojë objektivat për integrimin e Kosovës në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe të kontribuojë në zhvillimin e saj.

Vlerat kryesore në të cilat mbështetet puna e AKA-së janë:

*Pavarësia* – Vendimet e AKA-së merren në mënyrë të pavarur dhe të arsyetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të verifikueshme;

*Transparenca* – AKA udhëhiqet nga parimet e përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike përmes një politike efektive të informimit;

*Besueshmëria* – AKA organizon procese kredibile të sigurimit të jashtëm të cilësisë, ku komuniteti akademik dhe shoqëria në përgjithësi beson në punën e AKA-së;

---

<sup>6</sup> <https://akreditimi.rks-gov.net/accreditation/standards/>

*Profesionalizmi* – AKA aplikon standarde të larta profesionale të aplikuara në Evropë në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë.

## **2.2 Anëtarësimet dhe partneritetet**

AKA ishte pjesë e rrjeteve ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe vazhdon të jetë edhe për vitin 2023.

Në këtë vit, AKA vazhdon të jetë anëtare e:

- Rrjetit të Agjencive për sigurimin e Cilësisë në Evropën Qendrore dhe Lindore-CEENQA<sup>7</sup>.
- INQAAHE<sup>8</sup>, Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- ENQA Affiliate, AKA ka arritur që të marrë statusin ENQA Aftiliate, pas plotësimit të një varg kriteresh të cilat janë verifikuar nga Bordi i ENQA dhe më pas janë aprovuar nga Asambleja e ENQA në Stokholm.<sup>9</sup>
- AKA është bërë anëtare me të drejta të plota në Global Academic Integrity Network (GAIN). Rrjeti Global i Integritetit Akademik është një konsorcium agjencish për cilësinë dhe integritetin e arsimit në mbarë botën që bashkojnë forcat për të luftuar rritjen e shërbimeve tregtare të mashtrimit akademik që synojnë studentët, dhe ai mbështetet nga një sërë organesh të rëndësishme ndërkombëtare arsimore, si ENQA, Rrjeti Evropian për Integritetin Akademik dhe ETINED.<sup>10</sup>
- Ka vazhduar projekti i binjakëzimit me Agjencinë e Akreditimit të Austrisë.

## **3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KShC)**

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ose Bordi i AKA-së, është organ vendimmarrës i Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

<sup>7</sup> Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education. <https://www.ceenqa.org/>

<sup>8</sup> The International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education (INQAAHE) <https://www.inqaahe.org/>

<sup>9</sup> ENQA Affiliate <https://www.enqa.eu/membership-database/kaa-kosovo-accreditation-agency/>

<sup>10</sup> Global Academic Integrity Network (GAIN) <https://globalacademicintegrity.network/>



Këshilli Shtetëror i Cilësisë punon duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037, Ligji Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim<sup>11</sup>, Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018)<sup>12</sup>, Udhëzimin Administrativ për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KShC-së (Nr. 05/2018, dt.15.03.2018) sikur dhe mbështetet në Rregulloren mbi Punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Nr. 621/18D, dt.12.06.2018).

Legjislacioni në fuqi mundëson përzgjedhjen e anëtarëve të KShC-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave profesionale dhe transparente. Lista e përzgjedhur e të nominuarve ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në Rregulloren e punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, KShC cakton agjendat vjetore për procesin e akreditimit të IAL-ve, aprovon standardet, procedurat dhe kriteret e akreditimit, aprovon ekipet e ekspertëve të jashtëm, të propozuara nga drejtori i AKA, merr vendimet për akreditim si dhe aprovon Statutin dhe të gjitha rregulloret e AKA.

Përbërja aktuale e KShC-së është si vijon:

1. Prof. Asoc. Dr. Hasnije Ilazi, Kryetare;
2. Dr. Klemen Miklavic; Nënkryetar;
3. Prof. Ass. Dr. Gëzim Tosuni, anëtar;
4. Prof. Asoc.Dr. Maja Martinović, anëtare;
5. Prof. Dr. Jaakko Kauko, anëtar;
6. Prof. Dr. Mirlinda Batalli, anëtare
7. Prof. Dr. Avni Berisha, anëtar
8. Dr. Jetmir Haxhibeqiri, anëtar
9. Sipas detyrës, Drejtori i AKA-së, Naim Gashi.

Dy anëtarëve të KShC-së, Prof.Asoc.Dr. Dukagjin Zekës dhe Prof.Asoc.Dr. Rozafa Koliqit i ka skaduar mandati më 16 prill 2023. Anëtarët e ri të KShC janë: Prof. Dr. Jaakko Kauko i

---

<sup>11</sup> [Ligji nr. 08/L-110 për agjencinë e kosovës për akreditim \(rks-gov.net\)](https://rks.gov.net)

<sup>12</sup> [Udhëzim administrativ \(masht\) nr. 015/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në republikën e kosovës \(rks-gov.net\)](https://rks.gov.net)

zgjedhur nga Parlamenti i Kosovës më 10.07.2023, Prof. Dr. Mirlinda Batalli, Prof. Dr. Avni Berisha dhe Dr. Jetmir Haxhibeqiri të zgjedhur nga Parlamenti i Kosovës më dt. 14.02.2024.

Tabela 1: Aktivitetet kryesore të KShC për vitin 2023

Nr.	Përshkrimi	Data
1.	KShC ka shqyrtuar dhe ka vendosur për listën e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. KShC dhe AKA kanë rivlerësuar që nga fillimi listën ekzistuese të ekspertëve ndërkombëtarë nga e cila janë larguar ekspertët joaktivë, ndërsa si prioritet janë vendosur ekspertët nga vendet anëtare të ENQA-së. KShC ka vendosur që thirrja për ekspertë të jetë e hapur gjatë tërë vitit.	2023
2.	KShC ka shqyrtuar dhe ka vendosur për të gjitha raportet e vlerësimit të ekspertëve.	2023
3.	KShC ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e IAL-ve dhe ka shqyrtuar dhe proceduar te Komisioni i Ankesave të gjitha ankesat e IAL-ve.	2023
4.	Me qëllim të rritjes së transparencës dhe përfshirjen e të gjithë akterëve të arsimit të lartë në procesin e vendimmarrjes, KShC ka vazhduar takime me institucionet e arsimit të lartë të akredituara në Kosovë.	2023
5.	KShC aprovon standardet e rishikuara për akreditim	25.07.2023
6.	KShC-së së bashku me stafin e AKA-së kanë mbajtur punëtori për plotësimin e legjislacionit sekondar të dalur nga Ligji për Agjencinë e Akreditimit	10.11. 2023
7.	KShC takohet me përfaqësuesit e ENQA gjatë vizitës së tyre të progresit	11 tetor 2023
8.	KSHC ka hartuar Rregulloren për ekspertët ndërkombëtar	2023
9.	KShC dhe AKA organizojnë konferencën ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsim të lartë	24.09.2023
10	KShC dhe AKA kanë zhvilluar vizita në: Bruksel, Belgjikë ku janë takuar me krerët e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe institucione tjera të rëndësishme në	2023

	fushën e arsimit; Koln, Gjermani, ku janë takuar me krerët e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë nëpërmes Akreditimit të Programeve të Studimit (AQAS); dhe Bratislavë, Sllovaki ku janë takuar me drejtuesit e Agjencisë së Akreditimit të Sllovakisë për Arsimin e Lartë (SAAVS).	
11	KShC dhe AKA kanë takuar përfaqësuesit e të gjitha IAL-ve të akredituar në takimin e rregullt vjetor.	16.05.2023
12	KShC raporton në Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport në Parlamentin e Kosovës	04 07.2023

### 3.1. Mbledhjet dhe vendimet e KShC

Gjatë vitit 2023, KShC ka mbajtur 11 mbledhje dhe 2 votime online. Tabela më poshtë liston mbledhjet e mbajtura sipas radhës.

Tabela 2: Lista e mbledhjeve të mbajtura për vitin 2023

Nr	Data	Mbledhjet
1	28.02.2023	Takimi i 109 i KShC
2	28.03.2023	Takimi i 110 i KShC
3	14.04.2023	Takimi i 111 i KShC
4	08.05.2023	Takimi i 112 i KShC
5	26.06.2023	Takimi i 113 i KShC
6	13.07.2023	Takimi i 114 i KShC
7	25.08.2023	Takimi i 115 i KShC
8	25.09.2023	Takimi i 116 i KShC
9	20.10.2023	Takimi i 117 i KShC
10	21.11.2023	Takimi i 118 i KShC
11	28.12.2023	Takimi i 119 i KShC

Për secilën mbledhje të KShC-së, vendimet publikohen në ueb faqen zyrtare të AKA-së në profilin zyrtar në Facebook dhe në profilin në LinkedIn.

### **Sfidat kryesore të KShC në vitin 2023:**

- 1. Njohja e diplomave nga rajoni dhe më gjerë.** Ekziston një numër i madh i bartësve të programeve që kanë diplomuar si doktor i shkencës në shtet rajonale apo/edhe më gjerë, shtete këto me mungesë të theksuar të kapaciteteve dhe mekanizmave akreditues sipas ESG standardeve. Njohja e diplomave (nostrifikimi) sipas legjislacionit në fuqi nuk është në harmoni me mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, dhe si rrjedhojë përveç anës formale-procedurale, nuk ofron shqyrtim përmbajtjesor të disertacioneve, duke mundësuar kështu legjitimimin e diplomave me cilësi të dyshimtë. KShC nuk ka mekanizma për mënjanimin nga procesi i akreditimit të bartësve me doktorata të dyshimta apo jo cilësore, gjë që rrezikon sigurimin e cilësisë.
- 2. Cilësia e aplikimeve.** Gjatë punës së saj KShC është ballafaquar me cilësinë e dobët të aplikacioneve për akreditim të programeve. Gabime që kanë të bëjë me selektimin e kodeve nga ESAC (ang. Erasmus Subject Area Codes) dhe mospërputhshmëria e tyre me fushën e bartëseve, mospërputhja e kurseve të programit dhe profileve të bartëseve me “learning outcomes” të programit, cilësia e dobët e raporteve të vetëvlerësimit në kuptimin përmbajtjesor dhe cilësia e përkthimit në gjuhën angleze, janë disa nga probleme me të cilat ballafaqohet KShC gjatë shqyrtimit të aplikacioneve dhe vendimmarrjes.
- 3. Mungesë të kompetencës formale për orientimin e programeve të studimit.** KShC nuk ka mekanizma ligjor për orientimin e programeve studimore drejtë profileve që janë në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe tregut.
- 4. Validimi i akreditimit të marrë jashtë.** IAL-të të cilat posedojnë akreditim nga agjencione të akreditimit të një shteti tjetër kanë mundësinë që ta validojnë akreditimit e tyre në KShC pa pasur nevojë të ndjekin procedurat e plota për akreditim sipas legjislacionit në fuqi. Vendimmarrja e KShC në lidhje me validimin e programeve të tilla është sfidë e madhe pasi që kriteret dallojnë dhe pasqyra e qartë mbi të cilat kriteret është marr akreditimin nga agjencione ndërkombëtare mungon. KShC është në hartim e sipër të Rregullores për validim me të cilën do të eliminohet dallime esenciale në

procedura të akreditimit në mes të programeve të akredituara në Kosovë dhe të atyre të akredituara nga institucione ndërkombëtare.

- 5. Aktet nënligjore për Ligjin e AKA.** Ligji për AKA ka hyrë në fuqi në Korrik 2023 dhe do të ketë ndikim të madh pozitiv në veprimtarinë e AKA. Sfida mbetet hartimi dhe zbatimi akteve nënligjore përmes të cilëve do të mundësohet implementimi i plotë të Ligjit.

#### **4. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN 2023**

Vlerësimi institucional dhe i programeve të studimit është një aktivitet periodik i AKA-së. Ky proces bazohet në vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara nga institucioni aplikues (Raporti i vetëvlerësimit) dhe në bazë të të gjeturave gjatë vizitës në terren me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Bazuar në procedurat e publikuara të AKA-së, çdo IAL duhet të dëshmojë se plotëson kriteret e akreditimit me qëllim që të marrë akreditimin.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për akreditimin e institucioneve të Arsimit të Lartë (Nr. 15/2018), çdo IAL që paraqet kërkesë për akreditim ri/akreditim institucional të një apo më shumë programeve të studimit. Njëkohësisht IAL duhet të paraqesë edhe listën e stafit akademik, të deklaruar në AKA përmes platformës e-akreditimi për angazhim në po atë IAL, në programin përkatës për vitin përkatës akademik. Aplikacioni, së bashku me listën e stafit i nënshtrohet vlerësimit të përmbushjes së kriterëve formale dhe pas aprovimit nga KShC, ai përfshihet në agjendën vjetore të AKA për vlerësim. Në rast të vlerësimit negativ paraprak të aplikacionit nga KShC, ai refuzohet dhe nuk i nënshtrohet vlerësimit. Veç aplikacioneve dhe listat e stafit të aprovuar, IAL duhet të sjellë në AKA edhe Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) i cili i dërgohet ekipit vlerësues të jashtëm në një afat kohor të caktuar para vizitës fizike apo vlerësimit në distancë përmes takimeve online.


Në vitin 2023 AKA realizoi procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit mbi bazën e standardeve të rishikuara në vitin 2021 dhe Manualit të ri të Akreditimit në të cilën duhet të bazohen IAL gjatë hartimit të RVV. Këto standardet synojnë avancimin e cilësisë së përgjithshme të IAL-ve në Kosovë dhe fokusohen në konsolidimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë së tyre.

Gjatë vitit 2023 në AKA janë paraqitur 12 aplikacione për akreditim institucional. Prej tyre 10


i janë nënshtuar vlerësimit dhe 2 IAL nuk iu janë nënshtuar vlerësimit, pasi që nuk iu kanë aprovuar programet e studimit. Prej 10 IAL-ve të vlerësuara me ekipet e ekspertëve ndërkombëtarë, 7 janë akredituar ndërsa 2 nuk janë akredituar dhe një institucion është tërhequr nga procesi i akreditimit, pasi që është dorëzuar raporti negativ përfundimtar nga ekspertët e jashtëm.

Procesi i akreditimit në Kosovë për vitin 2023 është vlerësuar pozitivisht në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. Procesi i akreditimit në Kosovë është vlerësuar pozitivisht edhe nga monitoruesit vendorë dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Gjatë vitit 2023 për procesin e akreditimit (dhe validimit) kanë aplikuar gjithsej 119 programe të studimit (61 programe kanë qenë në nivelin Bachelor, 56 programe në nivelin Master ose të integruara dhe 2 programe të studimit në nivelin PhD ). Nga këto (119), 52 shosh janë refuzuar për shkak të mos përmbushjes së kritereve bazike, ndërsa 67 aplikacione për programe të studimit janë aprovuar nga KShC.




## Nga 67 aplikacione të aprovuara




Nga 67 programe të studimit të aprovuara nga KShC, AKA ka vlerësuar 66 shosh, 5 prej tyre janë validuar dhe një nuk është vlerësuar pasi që IAL nuk ka pasur akreditim institucional.

## Vlerësimi i programeve




Prej 66 programeve të vlerësuara me ekipe të ekspertëve ndërkombëtarë, 58 programe janë akredituar (17 programe për 5 vjet, 37 programe për 3 vjet dhe 4 programe 1 vjet) ndërsa 8 nuk janë akredituar.


## Nga 66 programe të vlerësuara



## Nga 66 programe të akredituara







## 5. KOMISIONI I ANKESAVE (KA)

### 5.1 Baza ligjore:

Komisioni i Ankesave (KA) ka kryer autorizimet e veta ligjore bazuar në Rregulloren e Komisionit të Ankesave 02/2019, të cilën e ka miratuar KSHC, dhe e cila është zbatuar nga data 31.05.2019 deri më 05.01.2024.

Më datë 29.06.2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligji Nr. 08/L-110 Për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, në të cilin ligj specifikohen autorizimet, struktura, mënyra e vendimmarrjes dhe aspekte tjera relevante për KA.

Me qëllim të normimit më të detajuar të veprimtarisë së KA-së, më datë 05.01.2024 është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja për KA.

### 5.2 Pjesëmarrje në hartim të legjislacionit dhe konferenca/punëtori:

Gjatë periudhës raportuese KA, përmes anëtarëve të vet ka qenë pjesë aktive në procesin e përpilimit të akteve nënligjore, si rrjedhojë e Ligjit për AKA.

KA ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare: “*Ndikimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë në krijimin e një kulture cilësore në arsimin e lartë*”, organizuar në Prishtinë me datë 26 Shtator 2023.

Kryesuesi i KA ka qenë pjesëmarrës në punëtorinë për zhvillimin e rregulloreve dhe procedurave për AKA e mbajtur në Ohër, Republika e Maqedonisë së Veriut - i cili event është mbajtur gjatë datave 20 -24 Dhjetor 2023.

### 5.3 Struktura dhe takimet e KA-së

Gjatë periudhës raportuese është zgjedhur kryesues i ri i KA, pas dorëheqjes së ish-kryesuesit i cili ka marrë një pozitë menaxheriale në Universitetin e Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe KA ka funksionuar me katër anëtarë, përkundër faktit se dispozitat ligjore përcaktojnë se duhet të janë 5 anëtarë. KA ka pasur kuorumin e mjaftueshëm për të trajtuar ankesat e IAL-vc.

KA gjatë periudhës raportuese ka mbajtur gjithsej 19 takime dhe atë në periudhat si në vijim:

Nr.	Muaji	Takime
1	Janar	0
2	Shkurt	1
3	Mars	4
4	Prill	3
5	Maj	3
6	Qershor	1
7	Korrik	1
8	Gusht	1
9	Shtator	1
10	Tetor	1
11	Nëntor	2
12	Dhjetor	1
<b>TOTAL: 19 takime</b>		

### 5.4 Vendimmarrja e KA-së

KA gjatë periudhës raportuese ka marrë një numër të caktuar të vendimeve dhe atë, me të dhënat si në vijim:

Nr.	Lloji i Vendimmarrjes	Numri i rasteve	Institucioni i Arsimit të lartë
1	Aprovim të Ankesës si të bazuar	3	UP-FSHMN; UP-FBV; Dardania
2	Aprovim i pjesshëm i Ankesës	2	AAB; UHZ
3	Përfundim i procedurës administrative	2	Heimerer; UP-FE

<b>4</b>	Pezullim i procedurës administrative	<b>1</b>	L.H. – Universiteti i Gjilanit	
<b>5</b>	Refuzim	<b>12</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Njësi</b>
			Universiteti i Prizrenit	1
			Universum	3
			Evolucion	1
			UBT	1
			Kolegji Biznes	1
			UP-FE	2
			Universiteti i Gjilanit	1
			Akademia për Siguri Publike	1
			Heimeier	1
<b>6</b>	Shtyrje afati për vendimmarrje	<b>10</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Njësi</b>
			Universum	2
			Evolucioni	1
			Universiteti i Mitrovices	1
			UP-FSHMN	1
			UP - FE	1
			UP-FBV	1
			UHZ	1
			UBT	1
			Heimeier	1
<b>TOTAL: 30 Vendime</b>				

## **6. AKTIVITETET DHE NGJARJET KRYESORE TË AGJENCISË SË AKREDITIMIT NË VITIN 2023**

### **6.1. Shqyrtimi i aplikacioneve të akreditimit dhe aprovimi i planit të aktiviteteve**

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), në mbledhjen e 108-të, e cila ka zgjatur tri ditë, i ka shqyrtuar aplikacionet e institucioneve të arsimit të lartë për akreditim institucional, akreditim dhe riakreditim të programeve të studimit. Institucionet e arsimit të lartë janë njoftuar me shkrim nga AKA-ja për vendimet e Këshillit. Në këtë mbledhje, KShC ka miratuar edhe listën e ekspertëve ndërkombëtarë që do të marrin pjesë në procesin e akreditimit. KShC ka miratuar edhe Planin e Aktiviteteve për vitin 2023, i cili buron nga Plani Strategjik i AKA-së.

### **6.2. Miratimi i Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim**

Më datën 07.06.2023 në Kuvendin e Kosovës është votuar Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Miratimi i këtij ligji garanton pavarësinë institucionale dhe financiare të AKA-së, ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, internacionalizimin e sistemit të arsimit dhe hapë rrugë për kthimin e AKA-së në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Rritje të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Ky Ligj është miratuar pas një pune të gjatë dhe me përkushtim të grupeve punuese të MASHTI-t, Komisionit për Arsim të Kuvendit të Kosovës, dhe vullnetit politik për përkrahje të pavarësisë së AKA-së. KShC dhe AKA kanë qenë të përfaqësuara në shumicën e takimeve të Komisionit Parlamentar për Arsim dhe në dëgjimet publike. Ligji për AKA është një tregues për ekzistimin e një kohezioni nacional për cilësinë në arsimin e lartë.

Kosova është vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që posedon ligj për akreditim dhe kjo është një arritje e madhe, e cila vendosë AKA-në dhe Kosovën si liderë në rajon sa i përket ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë.

### **6.3. Konferenca e parë ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka organizuar më 26.09.2023 Konferencën e parë ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në të cilën kanë marrë pjesë krerët e

institucioneve shtetërore, përfaqësues nga institucionet më të rëndësishme evropiane, përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, komuniteti akademik, studentë, përfaqësues diplomatik, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë Kryeministri i Republikës, Ministrija e MASHTI, deputetë të Komisionit Parlamentar për Arsim, përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, komunitetit akademik, industrisë, përfaqësues të studentëve, shoqërisë civile, donatorëve etj.

Përfaqësuesit e institucioneve vendore kanë ofruar përkrahje për AKA-në në rrugën e saj për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Nga organizatat ndërkombëtare kanë qenë prezentë në konferencë krerët e ENQA dhe EQAR, agjencitë homologe nga Gjermania, Kroacia, Austria, ekspertë nga vendet e ndryshme evropiane etj.

Partnerët ndërkombëtarë janë zotuar për përkrahjen e AKA-së dhe i kanë vlerësuar të arriturat për zbatimin e plotë të standardeve evropiane të cilësisë.

#### **6.4. Rishikimin e standardeve për nivelin institucional dhe të programeve**

Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), ka miratuar Standardet e rishikuara për akreditimin/riakreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në nivel institucional dhe të programeve të studimit bachelor dhe master.

Konform Ligjit për AKA-në këto standarde hyjnë në fuqi pas një viti dhe do të vlejnjë për të gjitha aplikacionet e reja që paraqiten për akreditim/riakreditim gjatë vitit 2024. AKA punon në avancimin e standardeve për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në përputhje me standardet evropiane të cilësisë (ESG) si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovë.

AKA është kujdesur që në hartimin e standardeve të përfshihen anëtarët vendorë dhe ndërkombëtarë të KShC-së, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të fushës së arsimit të lartë, institucionet e arsimit të lartë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësuesit e studentëve, përfaqësues të MASHTI-it, donatorë të fushës së arsimit dhe të gjithë akterët tjerë relevantë për arsimin e lartë.

Pas hartimit të draftit final nga grupi punues për hartimin e këtyre standardeve, AKA ka publikuar draftin për diskutim publik.

Pas përfundimit të afatit për diskutim publik, AKA ka adresuar komentet e pranuar dhe të njëjtat janë përcjellë për shqyrtim në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Në mbledhjen e 116-të, pas shqyrtimit të komenteve të parashtruara nga palët e interesuara, KShC aprovoi dokumentin final. Rishikimi i këtyre standardeve është përkrahur nga Heras plus dhe është financuar nga ADA Austriake.

### **6.5. Progres vizita e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA)**

Një ekip i ekspertëve të Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) më 11 tetor 2023 ka zhvilluar në Prishtinë, një vizitë të progresit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).

Vlerësuesit ndërkombëtarë: znj. Maria Weber (AQ Austria) dhe z. Klemen Subic (Slovenian Quality Assurance Agency) kanë adresuar të gjitha standardet e kapitullit 3 të ESG-ve, duke diskutuar kështu progresin e bërë nga AKA në misionin e saj për anëtarësim të plotë në ENQA dhe regjistrimin në EQAR.

Gjatë vizitës së progresit ekspertët e ENQA janë takuar me Këshillin Shtetëror të Cilësisë (KShC), stafin e AKA-së, me përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë, përfaqësuesen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si dhe me përfaqësuesit e donatorëve.

AKA ka dorëzuar në ENQA një raport të progresit, i cili ka qenë temë e diskutimit me ekspertët ndërkombëtarë.

Kjo vizitë nuk kishte karakter të vlerësimit, por kishte për qëllim diskutimin e progresit të AKA-së në plotësimin e kriterëve të përcaktuara me Udhëzuesit dhe Standardet Evropiane. Qëllimi i vizitës kishte karakter konsultativ dhe këshillëdhënës dhe shërben si tregues i arritjes së përmbushjes së standardeve nga AKA, para vlerësimit përfundimtar nga ENQA.

Ligji për AKA-në, plani strategjik, pavarësia institucionale, rritja e dialogut dhe bashkëpunimit me IAL-të, përfshirja e studentëve në procese të sigurimit të cilësisë etj, ishin vetëm disa nga çështjet e ngritura e për të cilat AKA tashmë ka shënuar progres të dukshëm.

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka mirëpritur edhe rekomandimet shtesë dhe ka shprehur zotimin e saj në përmbushje të tyre deri në vlerësimin e radhës nga ENQA.

## **6.6. Agjencia e Akreditimit ka zbatuar procesin e monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), gjatë vitit 2023 ka vazhduar procesin e monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, duke përmbushur kështu një rekomandim të rëndësishëm të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Procesi i monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre akademike, është edhe një nga rekomandimet e Komisionit Evropian në fushën e arsimit në Kosovë, në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit.

Ekipi i Agjencisë së Akreditimit, konform Metodologjisë së Monitorimit dhe Procedurave Pasakredituese, në fillim të procesit të monitorimit, ka monitoruar oraret e ligjëratave dhe ushtrimeve, si dhe vijueshmërinë e stafit akademik në 11 IAL.

Procesi i monitorimit e plotëson Standardin 2.3 të Udhëzuesve Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) i cili kërkon që agjencitë e sigurimit të cilësisë të përmyllin ciklin e akreditimit me procedura pasakredituese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Monitorimi është proces formal i kryer nga AKA përmes së cilit vlerësohet se institucioni i arsimit të lartë mirëmban dhe vazhdon të plotësojë, rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm dhe kushtet e dhëna të akreditimit si dhe zbaton standardet e Manualit të Akreditimit.

Ndërsa “Procedura pasakredituese” është proces i cili kufizohet në verifikimin e kushteve të akreditimit dhe konfirmimin e shkallës së përmbushjes së rekomandimeve nga AKA dhe zotimeve nga IAL dhe jo në rivlerësimin e standardeve të Manualit të Akreditimit.

Procesi i monitorimit është zhvilluar në IAL:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina": Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Filozofik dhe Fakulteti i Arteve;
- Universiteti "Isa Boletini", Mitrovicë;
- Kolegji AAB;
- Kolegji ESLG;
- Akademia Evolucion;
- Kolegji Heimerer; dhe
- Kolegji UBT.

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim në AKA, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për Agjencinë Kosovare të Akreditimit, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë 15/18, Manualin e Akreditimit të AKA-së, si dhe Metodologjinë e Monitorimit të AKA-së dhe Procedurat e Pas-Akreditimit, realizuan gjithashtu edhe procesin e monitorimit në distancë gjatë këtij viti, me fokus publikimet që lidhen me programet e studimit të akredituara të IAL-ve.

Sipas nenit 1.4 të Manualit të Monitorimit të AKA-së, "Monitorimi i faqeve të internetit të IAL-ve (media dhe rrjetet sociale) synon të sigurojë që informacioni i publikuar nga IAL-të lidhur me akreditimin e programeve të studimit të jetë i saktë dhe të mos krijojë konfuzion tek studentët, prindërit apo publiku i gjerë".

Si rezultat, AKA ka monitoruar dhe verifikuar të gjitha publikimet dhe shpalljet e programeve të studimit në përputhje me vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC). Gjatë këtij procesi, janë identifikuar disa informacione të pasakta, dhe AKA ka udhëzuar IAL-të që të përshtatin informacionin dhe publikimet në përputhje me vendimet e KShC-së brenda një afati të caktuar.

IAL-të janë informuar me shkrim dhe i kanë korrigjuar publikimet e tyre në media, faqet e tyre të internetit dhe rrjetet sociale, në përputhje me vendimet e KShC. Në rastet kur një institucion dështon të korrigojë informacionin brenda afatit të caktuar, AKA përgatit raporte me rekomandime për KShC.



Sipas Procedurës së Monitorimit dhe Pas Akreditimit të AKA-së, nëse KShC-ja e konsideron arsyetimin e institucionit si të pabazuar dhe se institucioni ka shkelur kushtet e akreditimit me veprimet e tij, mund të vendosë të fillojë një proces vlerësimi të jashtëm për programin e studimit dhe/ apo institucionit.

### **6.7. KShC themeloi Grupin punues për hartimin e rregulloreve që dalin nga Ligji i AKA-së**

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) ka themeluar Grupin punues për hartimin e rregulloreve që dalin nga Ligji i ri i AKA-së.

Ky grup përbëhej nga përfaqësues të KShC-së, AKA-së, Komisionit të Ankesave, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Konferencës së Rektorëve, Institutit UPCO dhe përfaqësuesit të shoqërisë civile. KShC-së po ashtu ka shqyrtuar edhe një numër të raporteve ta dala nga procesi i monitorimit, si dhe ka shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e parashtruara.

### **6.8. Sesion informues lidhur me standardet dhe procesin e akreditimit të programeve**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Rektori i Universitetit të Prishtinës kanë organizuar një sesion informues lidhur me standardet dhe procesin e akreditimit të programeve akademike, në të cilin kanë marrë pjesë koordinatorët e sigurimit të cilësisë dhe bartësit e programeve akademike nga të gjitha njësitet akademike të UP-së.

Koordinatorët e cilësisë dhe bartësit e programeve të studimit në UP, kanë bashkëbiseduar me drejtuesit e AKA-së lidhur me çështjet që lidhen me sigurimin e cilësisë.

Të dy palët janë dakorduar që të vazhdojnë takimet në afate periodike për të shkëmbyer idetë për avancimin e sistemit tonë të arsimit.

## **6.9. Aktivitete për zhvillimin e rregulloreve që dalin nga Ligji i ri**

Me mbështetje të projektit HEI'25, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka organizuar punëtori lidhur me zhvillimin e akteve nënligjore që dalin nga Ligji i ri për AKA-në. Në këto punëtori pjesëmarrës ishin: KShC, administrata, Komisioni i Ankesave, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, etj.

## **6.10 Sesion informues me IAL-të për procesin e aplikimit dhe deklarimit të stafit**

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka mbajtur një sesion informues me të gjitha IAL-të, për procesin e aplikimit për akreditim dhe ri-akreditim, të institucioneve dhe programeve të studimit, siç parasheh Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037 dhe Udhëzimin Administrativ 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Në këtë takim janë prezantuar formularët për aplikim si dhe të dhënat të cilat duhet të ngarkohen në platformën e-akreditimi.

Në këtë takim, po ashtu janë adresuar pyetjet shitesë nga përfaqësuesit e IAL-ve për sqarime të mëtejshme, në të cilat është përgjigjur stafi i Agjencisë së Akreditimit.

## **6.11 Përmbyllja e procesit të deklarimit për 2700 staf akademik në Kosovë**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka përfunduar me shumë sukses procesin e deklarimit të 2700 pjesëtarëve të stafit akademik të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Sipas legjislacionit në fuqi, koha e deklarimit të stafit akademik për vitin e ri të studimeve është nga data 1 deri më 31 tetor dhe ky proces është kryer me shumë sukses.

Si rezultat i avancimit të sistemit dhe ngritjes së resurseve humane, platforma elektronike 'E Akreditimi' ka qenë aktive dhe nuk ka pas asnjë problem teknik në funksionimin e saj.

Për të përfunduar me sukses këtë proces, AKA ka organizuar trajnime me të gjitha IAL-të, ka përgatitur një dokument shpjegues si dhe është përgjigjur në dhjetëra emaila dhe telefonata për ata që kanë pas nevojë për përkrahje teknike për deklaram në platformen e-akreditimi.

## **7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE E PARTNERË**

### **7.1. Përkrahje nga ENQA dhe EQAR për zbatimin e standardeve evropiane**

Një delegacion i KShC-së dhe AKA-së janë pritur në Bruksel nga krerët e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe institucione tjera të rëndësishme në fushën e arsimit.

Delegacioni nga Kosova ka marrë përkrahje nga ENQA dhe EQAR për punën e bërë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, zbatimin në praktikë të Standardeve dhe Udhëzuesve Evropian (ESG), si dhe plotësimin e rekomandimeve të ENQA.

Në ditën e parë të vizitës, në takime me institucione shumë të rëndësishme në Bruksel, kanë marrë pjesë Ministrja e MASHTI-it dhe Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim.

Vizita është përkrahur nga Projekti Heras Plus, i financuar nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Austrisë – ADA.

Në ditën e parë delegacioni nga Kosova është pritur nga Presidenti i EQAR-it, Karl Dittrich, drejtorja e EQAR-t, Magalie Soenen dhe zëvendësdrejtorja Melinda Szabó.

Delegacioni i Kosovës është pritur edhe nga drejtorja e ENQA, Anna Gover, ku është diskutuar për punën e AKA në zbatimin e standardeve evropiane të cilësisë.

Një tjetër takim shumë i rëndësishëm është zhvilluar me z. Patrick Van den Bosch drejtorin e Këshillit Flaman për Arsimin e Lartë (VLUHR).

Delegacioni i AKA-së është takuar edhe me Lucien Bollaert, nga Universiteti Gent i Belgjikës. Në takime të veçanta delegacioni kosovar është pritur edhe nga Asociacioni Evropian i Universiteteve (EUA), Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (AEQES) dhe Organizata e Akreditimit për Holandë dhe Flandri (NVAO).

## **7.2 Komisioni Evropian: AKA ka zbatuar rekomandimet për pavarësi institucionale dhe operationale**

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën<sup>13</sup>, i publikuar në Bruksel më 08.11.2023, e vlerëson pozitivisht punën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) si institucion që ka zbatuar rekomandimet për pavarësi institucionale e operationale si dhe për rritjen e kapaciteteve.

“Në shtator 2022, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) mori statusi i anëtarit affiliate të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Agjencia është aktualisht në procesin e aplikimit për anëtarësim në ENQA dhe Regjistrin Evropian të Sigurisë së Cilësisë. Kosova ka miratuar Ligjin për AKA-në, që synon të rrisë pavarësinë operative të agjencisë dhe transparencën e emërimeve të menaxhmentit”, thuhet në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën.

## **7.3 Agjencia e Akreditimit përfiton nga projekti i Shteteve të Bashkuara – USKEB**

Bordit për Shkëmbim Edukativ ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës (USKEB), i ka konfirmuar Agjencisë së Kosovës për Akreditim se është pranuar për financim “Hartimi i një analize tematike për akreditimin e programeve të studimit” nëpërmes Programit të Specialistëve Fulbright.

Sipas këtij projekti, një ekspert/e nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ka përkrahur Agjencinë e Akreditimit për hartimin e një analize tematike për procesin e akreditimit në nivel të programeve të studimit.

Analiza tematike është një nga kriteret që AKA duhet të plotësojë në nivel substancial. Pika 3.4 e Standardeve dhe Udhëzuesve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë kërkon që “Agjencitë duhet të publikojnë rregullisht raporte që pasqyrojnë dhe ofrojnë analizë të gjetjeve të aktivitetëve të tyre në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë”.

Nga 13 rekomandimet e dala nga vlerësimi i mëparshëm i ENQA-s, nga AKA kërkohet të “përdorë të dhënat e mbledhura gjatë proceseve të akreditimit dhe aktivitetëve të tjera për të

---

<sup>13</sup> [Kosovo Report 2023 - European Commission \(europa.eu\)](https://europeancommission.europa.eu)

kryer analiza tematike dhe sistematike për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë”.

Me mbështetjen e Ambasadës së SHBA, AKA ka zhvilluar më parë Metodologjinë për analiza tematike. Bazuar në këtë dokument vazhdimisht përgatiten analiza tematike që kanë për qëllim ofrimin e hulumtimeve sistematike që japin rekomandime konkrete për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Gjatë vitit 2023 AKA ka zhvilluar analizën tematike me temën: Zhvillimi i proceseve të akreditimit/ri akreditimit të programeve të studimit. Kjo përfshinë vlerësimin e proceseve trevjeçare të akreditimit në fushën e programeve të studimit (nivelet bachelor dhe master) në institucione publike dhe private.

#### **7.4 Kosova po përfiton nga përvoja austriake në fushën e akreditimit**

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka qenë nikoqir i një delegacioni nga Agjencia e Akreditimit e Austrisë (AQ Austria), i drejtuar nga dr. Maria Weber, drejtoreshë për Akreditim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Barbara Schinwald, Departamenti për Akreditim.

AQ Austria në kuadër të një projekti të përbashkët, të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim Ndërkombëtar ADA, po e përkrahë AKA-në për rritjen e kapaciteteve të saj dhe plotësimin e kriterëve për kthim në Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Delegacioni nga Austria është pritur në takim edhe nga Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MESTI).

Këto takime dhe vizita ofruan mundësi për diskutime të frytshme dhe shkëmbim njohurish në lidhje me proceset e akreditimit dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë midis institucioneve austriake dhe kosovare.

Binjakëzimi i AKA-së dhe AQ Austria është financuar nga Heras Plus, si pjesë e ADC. AKA dhe partnerët e saj vlerësojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin e AQ Austria në përpjekjet e tyre për të përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë.

## **7.5 AKA pjesë e shkëmbimit të stafit me Agjencinë Gjermane të Akreditimit ASIIN**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), në frymën e bashkëpunimit ka zhvilluar një aktivitet të përbashkët me agjencinë homologe gjermane, Agjencia e Akreditimit për Programet e Studimit në Inxhinieri, Informatikë, Shkenca Natyrore dhe Matematikë (ASIIN).

Ky shkëmbim i stafit është mundësuar nga Rrjeti i Evropës Qendrore të Agjencive për Akreditim (CEENQA) në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane të Akreditimit ASIIN.

Përveç zhvillimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve kadrovike, ky shkëmbim i stafit do të shërbej edhe për draftimin e Strategjisë për bashkëpunim dhe përkrahje të ASIIN ndaj AKA-së, me qëllim të rikthimit në Asociacioni Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

AKA në vazhdimësi promovon stafin e saj me qëllim të ngritjes dhe avancimit të politikave dhe shërbimeve të saja.

## **7.6 Nënshkruhet memorandum i mirëkuptimit në mes të AKA-së dhe projektit HEI'25**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe projekti “Intervenimet në arsimin e lartë 2025”, nënshkruan memorandum mirëkuptimi, me qëllim të konkretizimit të mëtejme të bashkëpunimit dhe bashkërenditjes së aktiviteteve që mbështeten nga projekti.

Projekti HEI'25 ka për qëllim t'i mbështetë proceset kryesore në arsimin e lartë që ndërlidhen me përmirësimin e cilësisë. Mbështetja për AKA-së do të përqendrohet në digjitalizimin e proceseve të punës dhe ngritjen e mëtejme të kapacitetit institucional për më shumë transparencë dhe efikasitet të punës e kredibilitet më të lartë.

Projekti HEI'25 financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), me kontribut të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

## **7.7 Agjencia e Kosovës për Akreditim nënshkruan kontratë për digjitalizim të proceseve**

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik për digjitalizimin e proceseve të brendshme, me mbështetje të projektit HEI25.

Projekti ka për qëllim që t'i digjitalizojë proceset dhe shërbimet e brendshme të AKA-së, përfshirë këtu aplikimin për akreditim, proceset monitoruese, deklarimin e stafit akademik, informimin akademik, gjenerimin e konfirmimeve etj. Softueri për akreditim, i cili do të zhvillohet me këtë rast, do të ketë 6 lloje të ndryshme të shfrytëzuesve: anëtarët e KShC-së, zyrtarët e AKA-së, ekspertët ndërkombëtarë, menaxhmentin dhe stafin e IAL-ve, studentët. Ky softuer do të mundësojë interaksion në mes të akterëve të ndryshëm, sipas detyrës dhe përgjegjësisë së tyre, njëherit duke mundësuar ngritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e efikasitetit, efijences, transparencës dhe llogaridhënies.

Pas një procesi transparent, profesional dhe të bazuar në kritere të qarta, dhe në të cilin kanë aplikuar 13 operatorë, komisioni vlerësues ka përzgjedhur operatorin Cloudarina, LLC, si fitues për zhvillim të softuerit. Ky projekt e ngrit në një nivel edhe më të lartë Agjencinë e Kosovës për Akreditim si institucion me shërbime të digjitalizuara dhe në interes të qytetarit.

Projekti HEI25 financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), me kontribut të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

## **7.8 Kosova dhe Sllovakia po bashkëpunojnë për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë**

Një delegacion i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) është pritur në Bratislavë nga drejtuesit e Agjencisë së Akreditimit të Sllovakisë për Arsimin e Lartë (SAAVS), me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin në fushën e cilësisë në arsimin e lartë, shkëmbimet akademike dhe mundësinë e projekteve të përbashkëta.

Delegacioni i AKA-së ka prezantuar punën e AKA-së në proceset e akreditimit, krijimin e mekanizmave për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë, si dhe për zbatimin e të gjitha rekomandimeve për rikthimin e plotë në Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në

Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Të dy delegacionet janë pajtuar për ta vazhduar bashkëpunimin në projekte të përbashkëta ndërkombëtare që lidhen me mekanizmat e sigurimit të cilësisë.

## **7.9 Agjencia e Akreditim dhe Qendra NARIC shkëmbim përvojash me Republikën Çeke**

Me qëllim të shkëmbimeve në fushën e cilësisë në arsimin e lartë, ekipi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe i Qendrës NARIC-Kosova, kanë qëndruar për tri ditë në një vizitë studimore në Republikën e Çekisë.

Ky projekt është përkrahur nga Higher Education Intervention 2025 Project (HEI 25), i financiar nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Austrisë (ADA).

Gjatë vizitës në Qendrën ENIC-NARIC të Çekisë është diskutuar për procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave dhe si për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Çekisë.

Si rezultat i besimit të dokumenteve të lëshuara nga institucionet e Kosovës, sipas homologëve çekë, deri më tani të gjitha diplomat nga Kosova janë njohur nga autoritetet çeke.

Delegacioni nga Kosova ka vizituar edhe Byronë Nacionale të Akreditimeve (NAB), ku është biseduar për bashkëpunimin në ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, me fokus të veçantë në procesin e digjitalizimit të shërbimeve.

Një vizitë e veçantë e delegacionit nga Kosova është zhvilluar edhe në Universitetin Charles në Pragë, ndër më të vjetrit në Evropë, ku është diskutuar për mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe ndikimin që kanë agjencitë e akreditimit për sigurimin e cilësisë brenda universiteteve.